



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

**ANALIZA NË FUSHËN E DEMOGRAFISË SIPAS SHTATË (7) RAJONEVE
ZHVILLIMORE**

Janar, 2026

Punuar nga:

Shyhrete Kastrati, Drejtoreshë e Departamentit për Përformancë dhe Analiza Rajonale

Fatmire Thaçi, Udhëheqëse e Divizionit për Performancë të Zhvillimit Rajonal të Balancuar

Xhevat Sefaj, Zyrtar për Zhvillim Socio - Ekonomik

Copyright. 2024 – Ministria e Zhvillimit Rajonal

Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë

Kati: III Ndërtesa ish Rilindja, Prishtinë

Tel: +383(0)38 200 64 526

<https://mzhr.rks-gov.net/>

PËRMBAJTJA:

❖	HYRJA DHE QËLLIMI.....	5
❖	PËRMBLEDHJE PËR RAJONET ZHVILLIMORE	5
❖	RAJONET ZHVILLIMORE SIPAS FUSHËVEPRIMITARISË SË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT RAJONAL:.....	6
❖	METODOLOGJIA.....	7
❖	NUMRI I PËRGJITHSHËM I POPULLSISË DHE DENDËSIA E POPULLSISË	8
❖	POPULLSIA, SIPËRFAQJA, NUMRI I VENDBANIMEVE DHE DENDËSIA NE KOMUNAT DHE RAJONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	9
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE POPULLSISË, SIPËRFAQJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NUMRI I VENDBANIMEVE DHE DENDËSIA NË NIVEL RAJONI	10
❖	LËVIZJET E POPULLSISË (MIGRIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR)	13
	POPULLSIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2023 DHE MIGRIMI NE NIVEL TE KOMUNAVE PËR VITIN 2024	14
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË SE REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE MIGRIMI NE NIVEL TE RAJONEVE ZHVILLIMORE PËR VITIN 2024	15
❖	NUMRI I LINDJEVE, NUMRI I TE VDEKURVE DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË PËR VITIN 2024	16
	TABELA E LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË SIPAS KOMUNAVE PËR VITIN 2024	17
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË SIPAS RAJONEVE PËR VITIN 2024.....	18
❖	STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË	19
	TABELA E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË.....	20
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE STRUKTURËS SË POPULLSISË SË RAJONEVE SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË	20
❖	NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT QENDËR	22
❖	LEVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN QENDËR	23
❖	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024	23
❖	NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN QENDËR	26
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NATALITETIT, MORTALITETIT DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN QENDËR PËR VITIN 2024.....	26
❖	STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN QENDËR	27
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË	27
❖	NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT VERI.....	29
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT VERI	29
❖	LËVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN VERI	30
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024.....	30
❖	NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN VERI	32
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN VERI PËR VITIN 2024	32
❖	STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN VERI	33
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË	33
❖	NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT PERËNDIM.....	35
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT PERËNDIM	35
❖	LËVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN PERËNDIM	36
	PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024.....	36
❖	NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN PERËNDIM	38

PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN PERENDIM PËR VITIN 2024	38
❖ STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN PERENDIM	39
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË	39
❖ NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT JUG.....	41
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT JUG	41
❖ LEVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN JUG	41
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024	42
❖ NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN JUG.....	44
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN JUG PËR VITIN 2024	44
❖ STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN JUG	45
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN JUG	45
❖ NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT JUGLINDJE.....	47
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT JUGLINDJE	47
❖ LEVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN JUGLINDJE	48
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024	48
❖ NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN JUGLINDJE	50
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN JUGLINDJE PËR VITIN 2024	50
❖ STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN JUGLINDJE	51
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN JUGLINDJE.....	51
❖ NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT LINDJE.....	53
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT LINDJE	53
❖ LEVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN LINDJE	54
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024	54
❖ NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN LINDJE	56
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN LINDJE PËR VITIN 2024.....	56
❖ STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN LINDJE	57
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN LINDJE	57
❖ NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT JUGPERENDIM.....	59
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT JUGPERENDIM.....	59
❖ LEVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN JUGPERENDIM	60
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024	60
❖ NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN JUGPERENDIM	62
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN JUGPERENDIM PËR VITIN 2024.....	62
❖ STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN JUGPERENDIM	63
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN JUGPERENDIM	63
❖ PËRFUNDIM.....	65

HYRJA DHE QËLLIMI

Demografia përbën një nga dimensionet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, social dhe territorial të një shteti. Struktura, shpërndarja dhe dinamika e popullsisë ndikojnë drejtpërdrejt në planifikimin e politikave publike, zhvillimin rajonal, tregun e punës, sistemin arsimor, shëndetësor dhe në qëndrueshmërinë e zhvillimit afatgjatë.

Qëllimi kryesor i kësaj analize është të ofrojë një vlerësim të strukturuar dhe gjithëpërfshirës të karakteristikave demografike të popullsisë së Kosovës, të ndarë sipas shtatë rajoneve zhvillimore, me synim mbështetjen e planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes institucionale.

Në mënyrë specifike, analiza synon:

- ✓ Të identifikojë karakteristikat kryesore demografike të secilit rajon zhvillimor;
- ✓ Të evidentojë dallimet dhe pabarazitë demografike ndërmjet rajoneve;
- ✓ Të analizojë trendet kryesore demografike dhe implikimet e tyre në zhvillimin socio-ekonomik;
- ✓ të ofrojë bazë analitike për hartimin e politikave zhvillimore dhe territoriale.

PËRMBLEDHJE PËR RAJONET ZHVILLIMORE

Numri i Përgjithshëm dhe dendësia e Popullsisë - Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2024 tregojnë se Republika e Kosovës ka gjithsej 1,602,515 banorë, prej të cilëve 804,538 femra ose 50.20% dhe 797,977 meshkuj ose 49.80% të popullsisë së përgjithshme.

Rajoni Qendër është rajoni më i populluar me 506,814 banorë, duke përfshirë rreth 31.6% të popullsisë totale dhe njëkohësisht ka dendësinë më të lartë të popullsisë, çka reflekton përqendrimin urban dhe ekonomik.

Rajonet Jug, Veri, Juglindje dhe Perëndim kanë popullsi mesatare, ndërsa Rajoni Lindje dhe Jugperëndim karakterizohen me numër më të ulët banorësh dhe dendësi më të vogël të popullsisë.

Në aspektin territorial, sipërfaqja e Kosovës është e shpërndarë relativisht në mënyrë të balancuar ndërmjet rajoneve, por shpërndarja e popullsisë nuk ndjek të njëjtin ritëm, duke treguar dallime të theksuara rajonale në zhvillim, urbanizim dhe presion demografik.

Lëvizjet e popullsisë - Të dhënat tregojnë se në vitin 2024, të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës kanë bilanc negativ të migrimit, me një humbje totale prej -28,415 banor, çka ka ndikuar në uljen e numrit të popullsisë krahasuar me vitin 2023.

Rajoni Qendër ka popullsinë më të madhe, mirëpo humbjen më të lartë nga migrimi e kanë Rajoni Jugperëndim me -6,572 banor dhe Rajoni Veri me 4,629 banor.

Në përgjithësi, tabela tregon se emigrimi ndërkombëtar mbetet faktori kryesor i rënies së popullsisë, ndërsa migrimi i brendshëm ka ndikim më të kufizuar. Kjo situatë nënvizon nevojën për politika zhvillimore rajonale dhe masa për frenimin e emigrimit, veçanërisht në rajonet me humbje më të theksuara demografike.

Lindjet, vdekjet dhe shtimi natyror sipas rajoneve - Të dhënat tregojnë se në vitin 2024, të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës kanë shënuar shtim natyror pozitiv, me gjithsej 20,998 lindje dhe 10,110 vdekje, duke rezultuar në një rritje natyrore prej 10,888 banorësh në nivel vendi.

Rajoni Qendër ka kontributin më të madh në shtimin natyror me 4,198 banor. Pas tij, Rajoni Juglindje me 1,483 banor dhe Rajoni Jug 1,230 banor paraqesin rritje të konsiderueshme natyrore ndërsa Rajoni Lindje ka shtimin natyror më të ulët me 790 banor.

Këto diferenca në shtimin natyror të popullsisë dëshmojnë për zhvillim rajonal të pabalancuar, ku përqendrimi i të rinjve dhe i potencialit njerëzor në Rajonin Qendër, i nxitur nga mundësitë më të mira ekonomike dhe sociale, ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e normës së lindshmërisë krahasuar me rajonet tjera.

Në përgjithësi, tabela dëshmon një dinamikë demografike pozitive në Kosovë gjatë vitit 2024, megjithëse intensiteti i rritjes natyrore ndryshon ndjeshëm nga një rajon në tjetrin.

Struktura e popullsisë sipas grupmoshave dhe rajoneve - Tabela tregon se popullsia e Kosovës ka një strukturë relativisht të favorshme demografike, ku dominon grupmosha 15–64 vjeç, me 1,063,687 banor apo 67% e popullsisë, duke përbërë pjesën kryesore të popullsisë aktive. Grupmosha 0–14 vjeç përfshin 348,004 banor apo 22% të popullsisë, ndërsa grupmosha 65+ arrin në 173,875 banor apo 11% të popullsisë, çka sinjalizon fillimin e procesit të plakjes së popullsisë, por ende në nivele të menaxhueshme.

Në grupmoshat 0 – 14 dominojnë meshkujt me 52.25% ndërsa femrat me 47.75%, grupmosha 15 – 64 vjeç janë të përafërta: femrat me 50.04% dhe meshkujt me 49.96% të popullsisë ndërsa në grupmoshën 65+ dominojnë femrat me 52.65% ndërsa meshkujt me 47.35%. Pra meshkujt janë më të shumtë në grupmoshën 0–14 vjeç, ndërsa femrat dominojnë lehtë në grupmoshat 15-64 dhe 65+, gjë që përputhet me jetëgjatësinë më të lartë të femrave.

Rajoni Qendër dhe Jug kanë numrin më të lartë të popullsisë aktive, grupmosha 15 – 64 vjeç, ndërsa rajonet tjera kanë shpërndarje më të balancuar.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një strukturë demografike stabile, me bazë të fortë të popullsisë aktive, por edhe me nevojë për politika afatgjata që adresojnë plakjen e popullsisë dhe shërbimet për të moshuarit në të ardhmen.

RAJONET ZHVILLIMORE SIPAS FUSHËVEPRIMTARISË SË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT RAJONAL:

01 - RAJONI ZHVILLIMOR QENDËR

02 - RAJONI ZHVILLIMOR VERI

03 - RAJONI ZHVILLIMOR PERËNDIM

04 - RAJONI ZHVILLIMOR JUG

05 - RAJONI ZHVILLIMOR JUGLINDJE

06 - RAJONI ZHVILLIMOR LINDJE

07 - RAJONI ZHVILLIMOR JUGPERËNDIM

METODOLOGJIA

Dokumenti „Analiza në Fushën e Demografisë sipas Shtatë Rajoneve Zhvillimore” është hartuar duke marr për bazë legjislacionin në fuqi. Në pjesën e parë të dokumentit është përfshirë një pasqyrë e qartë mbi numrin, strukturën dhe dinamikën e popullsisë së rajoneve zhvillimore në Republikën e Kosovës si një ndër faktorët themelorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, pastaj është vazhduar me analizën e këtyre treguesve në shtatë rajonet zhvillimore.

Demografia përbën bazën për planifikimin e politikave publike, veçanërisht në fushat e arsimit, shëndetësisë, punësimit dhe zhvillimit rajonal.

Në këtë analizë është përdorur metoda e analizës deskriptive statistikore, përmes së cilës janë analizuar dallimet ndërmjet rajoneve zhvillimore të Kosovës në aspektet kryesore demografike, duke përfshirë:

- ✓ Numrin e përgjithshëm dhe dendësinë e popullsisë;
- ✓ Lëvizjet e popullsisë;
- ✓ Numrin e lindjeve, numrin e vdekjeve dhe shtimin natyror të popullsisë;
- ✓ Strukturën e popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë.

Analizimi i dallimeve ndërmjet këtyre treguesve synon evidentimin e pabarazive rajonale në aspektin demografik ndërmjet rajoneve zhvillimore, vlerësimin e potencialeve për zhvillim dhe identifikimin e sfidave që burojnë nga ndryshimet demografike.

Përmes analizës së këtyre treguesve, synohet të ofrohet një kuptim i plotë i gjendjes demografike në nivel rajonal, si dhe të mbështeten proceset e vendimmarrjes për zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar rajonal.

Të dhënat e përdorura në këtë analizë bazohen në burimet zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

NUMRI I PËRGJITHSHËM I POPULLSISË DHE DENDËSIA E POPULLSISË

Republika e Kosovës sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2024 ka rreth 1,602,515 banorë¹, prej të cilëve 804,538 janë femra dhe 797,977 meshkuj, duke reflektuar me një shpërndarje pothuajse të balancuar gjinore.

Rajonet e renditura sipas numrit me te madhe te popullsisë janë: Rajoni Qendër me 506,814 banor, që përbën 31.63% të popullsisë së përgjithshme, Rajoni Jug 227,498 banor që përbën 14.20%, Rajoni Veri 190,591 banor që përbën 11.89%, Rajoni Juglindje 180,583 banor që përbën 11.27%, Rajoni Perëndim 174,031 banor që përbën 10.86%, Rajoni Jugperëndim 168,329 banor që përbën 10.50%.

Rajoni me popullsinë më të vogël është Rajoni Lindje me 154,669 banorë që përbën 9.65% të popullsisë së përgjithshme.

Në aspektin territorial, sipërfaqja e Kosovës është 10,905.25 km². Rajoni Qendër ka sipërfaqen më të madhe 2,081.10 km² ose 19% te territorit te Republikës se Kosovës, pastaj renditen Rajoni Veri me 2,051.84 km² ose 19%, Rajoni Perëndim me 1,659.98 km² ose 15%, Rajoni Jug me 1,432.69 km² ose 13%, Rajoni Lindje me 1,411.80 km² ose 13%, Rajoni Jugperëndim me 1,246.72 km² ose 11% ndërsa Rajoni Juglindje ka sipërfaqen më të vogël 1,021.12 km² ose 9% te territorit te Republikës se Kosovës.

Dendësia e popullsisë paraqet raportin ndërmjet numrit të banorëve dhe sipërfaqes së territorit. Dendësia mesatare e popullsisë në nivel vendi është 147 banor ne km², dendësinë më të lartë e ka Rajoni Qendër (244 banorë në km²), pastaj renditen Rajoni Juglindje (177 banorë në km²), Rajoni Jug (159 banorë në km²), Rajoni Jugperëndim (135 banorë në km²), Rajoni Lindje (110 banorë në km²), dhe dendësinë më të ulët e ka Rajoni Veri (93 banor ne km²).

Në bazë te dhënave ekziston shpërndarje jo e barabartë e popullsisë në raport me sipërfaqen, ku rajonet urbane dhe qendrore kanë dendësi më të lartë dhe peshë më të madhe demografike krahasuar me rajonet periferike.

Në Kosove janë gjithsej 1,469 vendbanime, të shpërndara në mënyrë jo të barabartë ndërmjet rajoneve: Rajoni Veri ka 336 vendbanime, numrin më te lartë në krahasim me rajonet tjera, pavarësisht se nuk ka popullsinë më të madhe. Kjo tregon një strukturë me shumë vendbanime të vogla dhe shpërndarje më të rrallë të popullsisë.

Rajoni Qendër ka 270 vendbanime, Rajoni Perëndim ka 220 vendbanime, Rajoni Lindje ka 192 vendbanime, Rajoni Jugperëndim ka 171 vendbanime, Rajoni Jug ka 154 vendbanime.

Rajoni Juglindje ka numrin më të vogël, vetëm 126 vendbanime, çka lidhet edhe me sipërfaqen më të vogël territoriale.

Tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të plotë të shpërndarjes demografike dhe territoriale të Republikës së Kosovës në nivel komunal dhe rajonal, duke evidentuar dallime të theksuara ndërmjet rajoneve si në numrin e popullsisë, ashtu edhe në dendësinë dhe sipërfaqen.

¹ Popullsia sipas komunave dhe gjinisë bazuar në Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë 2024, përfshirë Vlerësimin e Popullsisë për katër komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovica e Veriut, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Korrik 2025

POPULLSIA, SIPËRFAQJA, NUMRI I VENDBANIMEVE DHE DENDESIA NE KOMUNAT DHE RAJONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS


RAJONET	Nr.	KOMUNAT	MESHKUJ	FEMRA	POPULLSIA E KOSOVËS - REGJISTRIMI 2024	SIPERFAQJA Km2	VENDBANIMET SIPAS ASK	DENDESIA E POPULLSISE SIPAS KOMUNAVE	% E TOTALIT TË POPULLSISË PËR KOMUNA	% E TOTALIT TË SIPERFAQËS KATRORE PËR KOMUNA
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	114,882	112,584	227,466	523.13	43	435	14.19	4.72
	2	GLLOGOVC	23,945	24,134	48,079	275.63	35	174	3.00	2.53
	3	FUSHË KOSOVË	32,102	31,847	63,949	84.09	16	760	3.99	0.76
	4	GRAÇANICË	8,786	9,700	18,486	122.41	17	151	1.15	1.20
	5	LIPJAN	27,141	27,903	55,044	338.41	62	163	3.43	3.10
	6	OBILIQ	11,150	11,665	22,815	104.84	20	218	1.42	0.96
	7	PODUJEVË	35,155	35,820	70,975	632.59	77	112	4.43	5.81
RAJONI VERI	8	MITROVICË	32,101	32,641	64,742	329.35	46	197	4.04	3.04
	9	SKENDERAJ	19,983	20,681	40,664	374.37	49	109	2.54	3.43
	10	VUSHTRRI	29,912	31,616	61,528	344.85	67	178	3.84	3.17
	11	MITROVICA E V.	3,818	4,102	7,920	6.83	3	1,160	0.49	0.05
	12	LEPOSAVIQ	4,449	5,036	9,485	539.05	75	18	0.59	4.95
	13	ZVEQAN	1,351	1,516	2,867	123.01	35	23	0.18	1.13
	14	ZUBIN POTOK	1,610	1,775	3,385	334.38	61	10	0.21	3.06
RAJONI PERENDIM	15	PEJË	41,660	41,085	82,745	602.63	79	137	5.16	5.53
	16	ISTOG	16,511	16,497	33,008	454.36	50	73	2.06	4.17
	17	DEÇAN	13,887	13,888	27,775	293.97	37	94	1.73	2.73
	18	KLINË	15,474	15,029	30,503	309.02	54	99	1.90	2.84
RAJONI JUG	19	PRIZREN	73,972	73,274	147,246	626.86	76	235	9.19	5.53
	20	DRAGASH	14,085	14,811	28,896	433.85	36	67	1.80	3.95
	21	MAMUSHË	2,673	2,934	5,607	10.94	1	513	0.35	0.29
	22	SUHAREKË	23,033	22,716	45,749	361.04	41	127	2.85	3.31
RAJONI JUGLINDJE	30	FERIZAJ	54,223	55,032	109,255	344.61	45	317	6.82	3.17
	31	SHTIME	11,877	12,431	24,308	134.42	23	181	1.52	1.23
	32	KAÇANIK	13,681	14,035	27,716	211.28	31	131	1.73	1.94
	33	SHTËRPECË	5,141	5,630	10,771	247.70	16	43	0.67	2.28
	34	HANI I ELEZIT	4,091	4,442	8,533	83.11	11	103	0.53	0.76
RAJONI LINDJE	23	GJILAN	41,216	41,764	82,980	391.84	49	212	5.18	3.60
	24	VITI	17,647	17,919	35,566	269.69	39	132	2.22	2.48
	25	NOVOBËRDË	2,207	2,286	4,493	203.98	26	22	0.28	1.87
	26	KAMENICË	11,177	11,691	22,868	416.61	58	55	1.43	3.89
	27	KLLOKOT	1,435	1,606	3,041	23.39	4	130	0.19	0.21
	28	RANILLUGË	1,186	1,295	2,481	77.62	13	32	0.15	0.63
RAJONI JUGPERENDIM	29	PARTESH	1,548	1,692	3,240	28.67	3	113	0.20	0.27
	35	GJAKOVË	39,451	39,248	78,699	586.62	88	134	4.91	5.39
	36	MALISHEVË	22,572	21,316	43,888	306.42	44	143	2.74	2.81
	37	RAHOVEC	20,879	20,920	41,799	275.90	36	152	2.61	2.55
	38	JUNIK	1,966	1,977	3,943	77.78	3	51	0.25	0.68
GJITHSEJ			797,977	804,538	1,602,515	10,905.25	1,469	147	100.00	100.00

PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE POPULLSISË, SIPËRFAQJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NUMRI I VENDBANIMEVE DHE DENDESIA NË NIVEL RAJONI


NUMRI I POPULLSISË DHE SIPËRFAQJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË NIVEL RAJONI - REGJISTRIMI I POPULLSISË 2024

RAJONET	MESHKUJ	FEMRA	POPULLSIA E KOSOVËS - REGJISTRIMI 2024	NR. I SIPERFAQES KATRORE NE RAJONE	VENDBANIMET SIPAS ASK	% E TOTALIT TË POPULLSISË PËR RAJONE	% E TOTALIT TË SIPERFAQES KATRORE PËR RAJONE	DENDËSIA E POPULLSISË
RAJONI QENDËR	253,653	253,161	506,814	2,081.12	270	31.63	19.08	244
RAJONI VERI	97,367	93,224	190,591	2,051.84	336	11.89	18.82	93
RAJONI PERENDIM	86,499	87,532	174,031	1,659.93	220	10.86	15.22	105
RAJONI JUG	113,735	113,763	227,498	1,432.69	154	14.20	13.14	159
RAJONI JUGLINDJE	91,570	89,013	180,583	1,021.13	126	11.27	9.36	177
RAJONI LINDJE	78,253	76,416	154,669	1,411.80	192	9.65	12.95	110
RAJONI JUGPERENDIM	83,461	84,868	168,329	1,246.74	171	10.50	11.43	135
GJITHSEJ	804,538	797,977	1,602,515	10,905.25	1,469	100	100	147


% E TOTALIT TË POPULLSISË PËR RAJONET ZHVILLIMORE




% E TOTALIT TË SIPERFAQES KATRORE PËR RAJONET ZHVILLIMORE




% E DENDËSISË SË POPULLSISË SIPAS RAJONEVE EKONOMIKE



NUMRI I VENDBANIMEVE NE RAJONET ZHVILLIMORE



PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE FEMRAVE DHE MASHKUJVE NE VITIN 2024 SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE



LËVIZJET E POPULLSISË (MIGRIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR)

Lëvizjet e popullsisë përfshijnë migrimet kombëtare (nga një komunë apo rajon në tjetrin) dhe migrimet ndërkombëtare (emigrimi dhe imigrimi)².

Migrimi kombëtar përfshin lëvizjen e popullsisë brenda territorit të Kosovës, kryesisht nga zonat rurale drejt qendrave urbane. Ky proces është nxitur nga: mundësitë më të mira për punësim dhe arsim në qytete, zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike etj.

Rajoni i Prishtinës paraqet destinacionin kryesor të migrimit të brendshëm, ndërsa komunat rurale përreth përballen me zvogëlim të popullsisë dhe plakje demografike.

Migrimi ndërkombëtar përfshin të gjitha lëvizjet e njerëzve nga një shtet në një shtet tjetër, për periudha të përkohshme ose të përhershme. Kjo i referohet personave që largohen nga vendi i tyre për të jetuar, punuar, studiuar ose për arsye tjera në një vend tjetër.

Sipas të dhënave të paraqitura me poshtë numri i personave që kane imigruar në Kosovë nga jashtë (imigrant ndërkombëtarë) gjatë vitit 2024 është vlerësuar gjithsej 9,037 banor.

Ndërsa numri i personave që janë larguar nga Kosova për të jetuar jashtë vendit (emigrant ndërkombëtarë) gjatë vitit 2024 është vlerësuar gjithsej 37,448 banor. Kjo përfshin migrimin për arsye të bashkimit familjar, martesës, punësimit, studimeve afatgjata dhe shpërnguljes së përhershme.

Vlerësimi nxjerrë në pah se bilanci i migrimit ndërkombëtar në Kosovë për vitin 2024 rezulton të jetë -28,411 banor, duke reflektuar diferencën ndërmjet imigrimit dhe emigrimit

Gjatë vitit 2024 mbi 21,512 banor rezident në Kosovë ndërruan vendbanim, duke u shpërngulur nga një komunë në tjetrën.

Ky lloj migrimi i brendshëm është kryesisht rezultat i faktorëve socio-ekonomikë, përfshirë zhvendosjen nga zonat rurale në ato urbane, si dhe për shkak të martesave dhe punësimit.

Pavarësisht shtimit natyror pozitiv të popullsisë në vitin 2024 me 10,888 banorë, Kosova vazhdoi të përballlet me një bilanc negativ të migrimit ndërkombëtar.

Bilanci i migrimit të përgjithshëm³ për vitin 2024 ishte -28,415 banor, duke rezultuar në një rënie të përgjithshme të popullsisë për vitin 2024 (janar-dhjetor) prej -17,525 banor.

² Popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2024 në nivel të komunave, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Qershor 2025

³ Bilanci I migrimit të përgjithshëm përfshin bilancin kombëtar dhe bilancin ndërkombëtar të migrimit


POPULLSIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2023 DHE MIGRIMI NE NIVEL TE KOMUNAVE PËR VITIN 2024

RAJONET	NR	KOMUNAT	POPULLSIA E VLERËSUAR (31 DHJETOR 2023)	MIGRIMI NDËRKOMBËTAR			MIGRIMI KOMBËTAR			BILANCI PËRGJITHSHËM I MIGRIMIT NË NIVEL TË KOMUNAVE 2024	GJITHSEJ POPULLSIA DHE MIGRIMI
				IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR	IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT KOMBËTAR		
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	226,068	1,567	2,815	(1,248)	4,369	3,169	1,200	(48)	226,020
	2	GLLOGOVÇ	48,696	173	1,692	(1,519)	589	1,159	(570)	(2,089)	46,607
	3	FUSHË KOSOVË	60,209	683	860	(177)	4,518	722	3,796	3,619	63,828
	4	GRAÇANICË	17,870	114	58	56	694	65	629	685	18,555
	5	LIPJAN	55,098	258	1,229	(971)	700	767	(67)	(1,038)	54,060
	6	OBILIQ	22,974	46	324	(278)	183	375	(192)	(470)	22,504
	7	PODUJEVË	72,108	198	2,017	(1,819)	635	1,757	(1,122)	(2,941)	69,167
RAJONI VERI	8	MITROVICË	64,937	287	1,193	(906)	671	844	(173)	(1,079)	63,858
	9	SKENDERAJ	41,316	340	1,181	(841)	856	1,554	(698)	(1,539)	39,777
	10	VUSHTRRI	62,046	167	1,599	(1,432)	423	891	(468)	(1,900)	60,146
	11	MITROVICA E V.	7,951	8	33	(25)	13	39	(26)	(51)	7,900
	12	LEPOSAVIQ	9,500	6	7	(1)	13	20	(7)	(8)	9,492
	13	ZVEQAN	2,883	-	4	(4)	1	15	(14)	(18)	2,865
RAJONI PERENDIM	14	ZUBIN POTOK	3,402	-	19	(19)	1	16	(15)	(34)	3,368
	15	PEJË	82,971	417	1,846	(1,429)	602	770	(168)	(1,597)	81,374
	16	ISTOG	33,212	147	853	(706)	227	391	(164)	(870)	32,342
	17	DEÇAN	27,883	131	585	(454)	148	244	(96)	(550)	27,333
RAJONI JUG	18	KLINË	30,736	83	1,223	(1,140)	476	642	(166)	(1,306)	29,430
	19	PRIZREN	147,288	1,347	3,568	(2,221)	918	961	(43)	(2,264)	145,024
	20	DRAGASH	29,043	102	404	(302)	130	269	(139)	(441)	28,602
	21	MAMUSHË	5,596	6	19	(13)	1	1	-	(13)	5,583
RAJONI JUGLINDJE	22	SUHAREKË	46,033	198	1,564	(1,366)	227	432	(205)	(1,571)	44,462
	30	FERIZAJ	108,386	582	2,041	(1,459)	1,958	1,087	871	(588)	107,798
	31	SHTIME	24,364	117	515	(398)	213	301	(88)	(486)	23,878
	32	KAÇANIK	28,107	216	696	(480)	216	622	(406)	(886)	27,221
RAJONI LINDJE	33	SHTËRPECË	10,850	3	14	(11)	22	106	(84)	(95)	10,755
	34	HANI I ELEZIT	8,655	43	65	(22)	25	161	(136)	(158)	8,497
	23	GJILAN	83,128	518	2,182	(1,664)	898	967	(69)	(1,733)	81,395
	24	VITI	35,809	258	1,268	(1,010)	423	623	(200)	(1,210)	34,599
	25	NOVOBËRDË	4,507	5	104	(99)	71	70	1	(98)	4,409
	26	KAMENICË	23,289	128	769	(641)	112	467	(355)	(996)	22,293
	27	KLLOKOT	3,070	8	48	(40)	23	46	(23)	(63)	3,007
RAJONI JUGPERENDIM	28	RANILLUGË	2,482	3	11	(8)	13	9	4	(4)	2,478
	29	PARTESH	3,238	6	14	(8)	8	3	5	(3)	3,235
	35	GJAKOVË	79,031	470	2,230	(1,760)	487	758	(271)	(2,031)	77,000
	36	MALISHEVË	44,269	196	2,228	(2,032)	555	842	(287)	(2,319)	41,950
RAJONI JUGPERENDIM	37	RAHOVEC	42,175	161	2,080	(1,919)	71	330	(259)	(2,178)	39,997
	38	JUNIK	3,940	45	90	(45)	22	21	1	(44)	3,896
GJITHSEJ			1,603,120	9,037	37,448	-28,411	21,512	21,516	-4	-28,415	1,574,705


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË SE REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE MIGRIMI NE NIVEL TE RAJONEVE ZHVILLIMORE PËR VITIN 2024

RAJONET	POPULLSIA E VLERËSUAR (31 DHJETOR 2023)	MIGRIMI NDËRKOMBËTAR 2024			MIGRIMI KOMBËTAR (2024)			BILANCI I PËRGJITHSHËM I MIGRIMIT NË NIVEL TË RAJONEVE ZHVILLIMORE 2024	GJITHSEJ POPULLSIA DHE MIGRIMI
		IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR	IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT KOMBËTAR		
RAJONI QENDËR	503,023	3,039	8,995	-5,956	11,688	8,014	3,674	-2,282	500,741
RAJONI VERI	192,035	808	4,036	-3,228	1,978	3,379	-1,401	-4,629	187,406
RAJONI PERENDIM	174,802	778	4,507	-3,729	1,453	2,047	-594	-4,323	170,479
RAJONI JUG	227,960	1,653	5,555	-3,902	1,276	1,663	-387	-4,289	223,671
RAJONI JUGLINDJE	180,362	961	3,331	-2,370	2,434	2,277	157	-2,213	178,149
RAJONI LINDJE	155,523	926	4,396	-3,470	1,548	2,185	-637	-4,107	151,416
RAJONI JUGPERENDIM	169,415	872	6,628	-5,756	1,135	1,951	-816	-6,572	162,843
GJITHSEJ	1,603,120	9,037	37,448	-28,411	21,512	21,516	-4	-28,415	1,574,705

MIGRIMI NDËRKOMBËTAR 2024



MIGRIMI KOMBËTAR



NUMRI I LINDJEVE, NUMRI I TE VDEKURVE DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË PËR VITIN 2024

Dinamika natyrore e popullsisë në Kosovë përcaktohet nga raporti ndërmjet numrit të lindjeve dhe numrit të vdekjeve gjatë një periudhe të caktuar kohore, ndërsa shtimi natyror paraqet diferencën midis këtyre dy proceseve.

Analiza e këtyre treguesve ndihmon në kuptimin e tendencave të rritjes apo tkurrjes së popullsisë dhe janë thelbësorë për vlerësimin e zhvillimeve demografike dhe për planifikimin e politikave sociale, ekonomike dhe zhvillimore. Numri i lindjeve gjatë vitit 2024 paraqet bazën kryesore të rritjes natyrore të popullsisë. Të dhënat tregojnë se lindjet vazhdojnë të jenë më të larta se vdekjet në shumicën e komunave, duke reflektuar një trend pozitiv, megjithëse me dallime të theksuara.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mëposhtme del se: Norma mesatare e lindshmërisë⁴ është rreth 13 lindje për 1,000 banor. Rajonet me numër më të lartë të lindjeve në vite janë: Rajoni Qendër me 6,857 lindje, Rajoni Jug me 2,707 lindje, Rajoni Veri me 2,533 lindje, Rajoni Juglindje me 2,469 lindje, Rajoni Jugperëndim me 2,329 lindje, Rajoni Perëndim me 2,100 lindje ndërsa Rajoni Lindje është rajoni me numër më të vogël, 2,003 lindje në vite.

Numri i të vdekurve gjatë vitit 2024 pasqyron strukturën e moshës së popullsisë dhe kushtet shëndetësore. Vdekjet janë më të theksuara në rajonet me popullsi më të madhe dhe me përqindje më të lartë të popullsisë së moshuar. Megjithatë, në nivel të përgjithshëm, vdekjet mbeten në nivele më të ulëta krahasuar me lindjet, duke mos e neutralizuar rritjen natyrore. Norma mesatare e vdekshmërisë⁵ është rreth 6-7 vdekje për 1,000 banorë. Rajonet me numër më të lartë të vdekshmërisë janë: Rajoni Qendër me 2,659 vdekje në vite, Rajoni Jug me 1,477 vdekje në vite, Rajoni Veri me 1,378 vdekje në vite, Rajoni Perëndim me 1,275 vdekje në vite, Rajoni Jugperëndim me 1,122 vdekje në vite, Rajoni Lindje me 1,213 vdekje në vite, ndërsa Rajoni Juglindje është rajoni me numër më të vogël me 986 vdekje në vite.

Shtimi natyror, si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve, për vitin 2024 rezulton pozitiv, çka tregon se popullsia vazhdon të rritet në mënyrë natyrore. Megjithatë, intensiteti i këtij shtimi ndryshon nga një rajon apo komunë në tjetrën. Sa i përket rajoneve me shtim natyror më të lartë janë: Rajoni Qendër me 4,198 banor, Rajoni Juglindje me 1,483 banor, Rajoni Jug me 1,230 banor, Rajoni Jugperëndim me 1,207 banor, Rajoni Veri me 1,155 banor ndërsa Rajoni Perëndim me 825 banor dhe Rajoni Lindje me 790 banor, tregojnë rritje më të ngadaltë për shkak të lindshmërisë më të ulët dhe vdekshmërisë më të lartë.

Popullsia e Kosovës vazhdon të ketë shtim natyror pozitiv, ndonëse me një tendencë të ngadalësuar gjatë viteve të fundit.

⁴ Numri total i lindjeve pjesuar me numrin total të banoreve dhe shumëzuar me 1000

⁵ Numri total i vdekjeve pjesuar me numrin total të banoreve dhe shumëzuar me 1000


TABELA E LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË SIPAS KOMUNAVE PËR VITIN 2024

RAJONI	NR.	KOMUNA	NUMRI I LINDJEVE 2024	NUMRI I VDEKJEVE 2024	SHTIMI NATYROR 2024
RAJONI QENDER	1	GLLOGOC	782	268	514
	2	FUSHË KOSOVË	804	238	566
	3	LIPJAN	793	283	510
	4	OBILIQ	382	156	226
	5	PODUJEVË	1075	448	627
	6	PRISHTINË	2870	1152	1718
	7	GRAÇANICË	151	114	37
RAJONI VERI	8	MITROVICË	800	456	344
	9	MITROVICË E VERIUT	103	78	25
	10	LEPOSAVIQ	37	50	-13
	11	SKENDERAJ	595	316	279
	12	VUSHTRRI	917	404	513
	13	ZUBIN POTOK	45	32	13
	14	ZVEÇAN	36	42	-6
RAJONI PERENDIM	15	DEÇAN	311	215	96
	16	ISTOG	383	261	122
	17	KLINË	443	212	231
	18	PEJË	963	587	376
RAJONI JUG	19	DRAGASH	228	193	35
	20	PRIZREN	1858	944	914
	21	MAMUSHË	76	23	53
	22	SUHAREKË	545	317	228
RAJONI JUGLINDJE	23	KAÇANIK	421	153	268
	24	SHTIME	379	119	260
	25	SHTËRPCË	110	90	20
	26	FERIZAJ	1459	581	878
	27	HANI I ELEZIT	100	43	57
RAJONI LINDJE	28	GJILAN	1074	626	448
	29	KAMENICË	241	223	18
	30	NOVOBËRDË	86	57	29
	31	VITI	527	229	298
	32	RANILLUG	21	27	-6
	33	PARTESH	26	35	-9
	34	KLLOKOT	28	16	12
RAJONI JUGPERENDIM	35	GJAKOVË	1031	582	449
	36	RAHOVEC	557	271	286
	37	MALISHEVË	702	240	462
	38	JUNIK	39	29	10
GJITHSEJ			20,998	10,110	10,888

PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË SIPAS RAJONEVE PËR VITIN 2024

RAJONET	NUMRI I LINDJEVE 2024	NUMRI I VDEKJEVE 2024	SHTIMI NATYROR 2024
RAJONI QENDER	6,857	2,659	4,198
RAJONI VERI	2,533	1,378	1,155
RAJONI PERENDIM	2,100	1,275	825
RAJONI JUG	2,707	1,477	1,230
RAJONI JUGLINDJE	2,469	986	1,483
RAJONI LINDJE	2,003	1,213	790
RAJONI JUGPERENDIM	2,329	1,122	1,207
GJITHSEJ	20,998	10,110	10,888

PARAQITJA GRAFIKE E LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË SIPAS RAJONEVE PËR VITIN 2024



STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË

Struktura e popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë përbën një ndër treguesit më të rëndësishëm demografikë, pasi reflekton potencialin ekonomik, social dhe zhvillimor të një vendi apo rajoni. Analiza e shpërndarjes së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë mundëson vlerësimin e nevojave për arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe sociale, si dhe ndihmon në planifikimin afatgjatë të zhvillimit rajonal dhe kombëtar.

Në Republikën e Kosovës, dinamika e popullsisë karakterizohet nga një strukturë relativisht të re, por me tendencë graduale të plakjes së popullsisë në disa rajone, si pasojë e migrimit të rinjve. Popullsia zakonisht ndahet në tri grupe kryesore sa i përket moshës:

- ✓ 0–14 vjeç: popullsia e re, zakonisht në varësi nga familja dhe sistemi arsimor;
- ✓ 15–64 vjeç: popullsia aktive, që përfshin forcat e punës;
- ✓ 65 vjeç e më shumë: popullsia e moshuar, zakonisht në varësi ekonomike dhe sociale.

Rajonet me pjesëmarrje të lartë të grupmoshës 0–14 vjeç kanë potencial për rritje afatgjatë, por kërkojnë investime më të mëdha në arsim e punësim, rajonet ku dominon grupmosha 15–64 vjeç kanë strukturë më produktive dhe përfaqësojnë zonat me potencial më të madh ekonomik, ndërsa rajonet me përqindje të lartë të grupmoshës 65+ përballen me sfida sociale, mungesë të fuqisë punëtore dhe kërkesa më të mëdha për kujdes shëndetësor.

Në nivel vendi, struktura e popullsisë në Kosovë tregon një bazë të gjerë të piramidës demografike, duke reflektuar pjesëmarrje të lartë të popullsisë së re, megjithëse ndryshimet rajonale janë të theksuara.

Raporti gjinor përfaqëson numrin e meshkujve për 100 femra.

Sipas të dhënave, raporti gjinor është relativisht i balancuar në Republikën e Kosovës lëviz rreth 101 meshkuj për 100 femra⁶.

Struktura e popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë është tregues kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të rajoneve të Kosovës.

Rajonet me popullsi të re kanë potencial zhvillimor, por kërkojnë më shumë investime në arsim dhe punësim.

Rajonet me popullsi të plakur kërkojnë politika të përshtatura për kujdes shëndetësor dhe pensione të qëndrueshme.

Analiza e këtyre treguesve është thelbësore për hartimin e politikave të zhvillimit rajonal, duke siguruar një shpërndarje të drejtë të resurseve dhe planifikim afatgjatë të qëndrueshëm për vendin.

Ky tregues mat ngarkesën që bart popullsia aktive (15–64 vjeç) për mbajtjen e grupeve të varura (0–14 dhe 65+)


⁶ Raporti gjinor llogaritet: Numri i meshkujve/Numri i femrave×100

**TABELA E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË
PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE STRUKTURËS SË POPULLSISË SË RAJONEVE SIPAS
GRUPMOSHAVE DHE GJINISË**


GRUPMOSHA - GJITHSEJ							GRUPMOSHA - FEMRA				GRUPMOSHA - MASHKUJ				
RAJ.	NR.	KOMUNA	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	50,164	153,436	23,866	227,466	23,936	78,286	12,660	114,882	26,228	75,150	11,206	112,584	
	2	GLLOGOVC	11,803	31,710	4,566	48,079	5,662	15,918	2,365	23,945	6,141	15,792	2,201	24,134	
	3	FUSHË KOSOVË	16,510	42,524	4,915	63,949	7,831	21,659	2,612	32,102	8,679	20,865	2,303	31,847	
	4	GRAÇANICË	3,680	12,450	2356	18,486	1,786	5,779	1221	8,786	1,894	6,671	1135	9,700	
	5	LIPJAN	13,240	36,602	5,202	55,044	6,324	18,109	2,708	27,141	6,916	18,493	2,494	27,903	
	6	OBILIQ	5,448	15,176	2191	22,815	2,595	7,420	1135	11,150	2,853	7,756	1056	11,665	
	7	PODUJEVË	16,163	47,736	7,076	70,975	7,848	23,690	3,617	35,155	8,315	24,046	3,459	35,820	
RAJONI VERI	8	MITROVICË	14,571	42,784	7,387	64,742	7,017	21,164	3,920	32,101	7,554	21,620	3,467	32,641	
	9	SKENDERAJ	8,993	27,200	4,471	40,664	4,329	13,347	2,307	19,983	4,664	13,853	2,164	20,681	
	10	VUSHTRRI	13,937	41,079	6,512	61,528	6,570	20,070	3,272	29,912	7,367	21,009	3,240	31,616	
	11	MITROVICA E V.	1087	5118	1715	7,920	520	2452	846	3,818	567	2,666	869	4,102	
	12	LEPOSAVIQ	1050	6214	2221	9,485	479	2894	1076	4,449	571	3,320	1,145	5,036	
	13	ZVEQAN	377	1859	631	2,867	180	866	305	1,351	197	993	326	1,516	
	14	ZUBIN POTOK	445	2205	735	3,385	213	1040	357	1,610	232	1,165	378	1,775	
RAJONI PERENDIM	15	PEJË	16,765	55,122	10,858	82,745	8025	27855	5780	41,660	8,740	27,267	5078	41,085	
	16	ISTOG	6,623	22,228	4,157	33,008	3262	11077	2172	16,511	3,361	11,151	1985	16,497	
	17	DEÇAN	5,637	18,448	3,690	27,775	2,726	9,146	2,015	13,887	2,911	9,302	1,675	13,888	
	18	KLINË	6,795	20,076	3,632	30,503	3,279	10,305	1,890	15,474	3,516	9,771	1,742	15,029	
RAJONI JUG	19	PRIZREN	31,825	99,076	16,345	147,246	15,147	50,078	8,747	73,972	16,678	48,998	7,598	73,274	
	20	DRAGASH	5,337	19,396	4,163	28,896	2,525	9,319	2,241	14,085	2,812	10,077	1,922	14,811	
	21	MAMUSHË	1401	3845	361	5,607	648	1838	187	2,673	753	2,007	174	2,934	
	22	SUHAREKË	9,638	30,762	5,349	45,749	4,508	15,714	2,811	23,033	5,130	15,048	2,538	22,716	
RAJONI JUGLINDJE	30	FERIZAJ	25,027	73,538	10,690	109,255	12,097	36,573	5,553	54,223	12,930	36,965	5,137	55,032	
	31	SHTIME	5,722	16,354	2232	24,308	2,716	8,017	1144	11,877	3,006	8,337	1088	12,431	
	32	KAÇANIK	6,447	18,613	2,656	27,716	3,149	9,107	1,425	13,681	3,298	9,506	1,231	14,035	
	33	SHTËRPECË	1745	7137	1889	10,771	780	3362	999	5,141	965	3775	890	5,630	
RAJONI LINDJE	34	HANI I ELEZIT	2086	5716	731	8,533	966	2724	401	4,091	1120	2992	330	4,442	
	23	GJILAN	16,463	57,237	9,280	82,980	7,871	28,485	4,860	41,216	8,592	28,752	4,420	41,764	
	24	VITI	7,753	24,069	3,744	35,566	3,778	11,925	1,944	17,647	3,975	12,144	1,800	17,919	
	25	NOVOBËRDË	1067	2957	469	4,493	518	1443	246	2,207	549	1514	223	2,286	
	26	KAMENICË	3,731	15,680	3,457	22,868	1,789	7,608	1,780	11,177	1,942	8,072	1,677	11,691	
	27	KLLOKOT	632	2084	325	3,041	293	977	165	1,435	339	1107	160	1,606	
RAJONI JUGPERENDIM	28	RANILLUGË	403	1608	470	2,481	189	769	228	1,186	214	839	242	1,295	
	29	PARTESH	478	2191	571	3,240	224	1029	295	1,548	254	1162	276	1,692	
	35	GJAKOVË	15,729	52,881	10,089	78,699	7,363	26,515	5,573	39,451	8,366	26,366	4,516	39,248	
	36	MALISHEVË	11,372	28,677	3,839	43,888	5,348	15,251	1,973	22,572	6,024	13,426	1,866	21,316	
	37	RAHOVEC	9,075	28,185	4,539	41,799	4,237	14,272	2,370	20,879	4,838	13,913	2,169	20,920	
	38	JUNIK	677	2731	535	3,943	317	1347	302	1,966	360	1384	233	1,977	
	GJITHSEJ			349,896	1,074,704	177,915	1,602,515	167,045	537,430	93,502	797,977	182,851	537,274	84,413	804,538

GRUPMOSHA SIPAS RAJONIT - GJITHSEJ					GRUPMOSHA SIPAS RAJONIT - FEMRA				GRUPMOSHA SIPAS RAJONIT - MASHKUJ			
RAJONET	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ
RAJONI QENDËR	117,008	339,634	50,172	506,814	55,982	170,861	26,318	253,161	61,026	168,773	23,854	253,653
RAJONI VERI	40,460	126,459	23,672	190,591	19,308	61,833	12,083	93,224	21,152	64,626	11,589	97,367
RAJONI PERENDIM	35,820	115,874	22,337	174,031	17,292	58,383	11,857	87,532	18,528	57,491	10,480	86,499
RAJONI JUG	48,201	153,079	26,218	227,498	22,828	76,949	13,986	113,763	25,373	76,130	12,232	113,735
RAJONI JUGLINDJE	41,027	121,358	18,198	180,583	19,708	59,783	9,522	89,013	21,319	61,575	8,676	91,570
RAJONI LINDJE	30,527	105,826	18,316	154,669	14,662	52,236	9,518	76,416	15,865	53,590	8,798	78,253
RAJONI JUGPERENDIM	36,853	112,474	19,002	168,329	17,265	57,385	10,218	84,868	19,588	55,089	8,784	83,461
GJITHSEJ	349,896	1,074,704	177,915	1,602,515	167,045	537,430	93,502	797,977	182,851	537,274	84,413	804,538

PARAQITJA GRAFIKE E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE SIPAS RAJONEVE



PARAQITJA GRAFIKE E POPULLSISË SIPAS GJINISË DHE SIPAS RAJONEVE





NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT QENDËR

Rajoni zhvillimor qendër ka popullsi prej 506,814 banor prej të cilëve 253,653 janë femra dhe 253,161 janë mashkuj, ka sipërfaqe prej 2,081.10 km², ky rajon përbën 31.63% të tërë popullsisë dhe 19% te tere sipërfaqes së Republikës së Kosovës⁷. Kjo tregon për një koncentrim shumë më të madhë të popullsisë në Rajonin Qendër se në rajonet tjera. Mesatarisht, në këtë rajon jetojnë rreth 244 banor në 1 km². Dendësinë më të madhe të popullsisë në rajonin Qendër e ka komuna e Fushë Kosovës me 760 banorë në 1 km². Komuna e dytë me radhë për nga dendësia është komuna e Prishtinës me 435 banor që jetojnë në 1 km², ndërsa dendësia më e vogël e popullsisë është ne komunën e Podujevës me 112 banor ne 1km².



PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPËRFAQËS SË RAJONIT QENDËR

NR	KOMUNAT	REGJISTRIMI I POPULLËSISË 2024	SIPERFAQJA km ²	VENDBANIMET	% E PJESËMARRJËS SË POPULLËSISË SË KOMUNAVE NË TOTALIN E POPULLËSISË SË RAJONIT	% E PJESËMARRJËS SË SIPERFAQËS SË KOMUNAVE NË TOTALIN E SIPERFAQËS SË RAJONIT
1	PRISHTINË	227,466	523.14	43	44.88	25.14
2	GLLOGOC	48,079	275.63	35	9.49	13.24
3	FUSHË KOSOVË	63,949	84.09	16	12.62	4.04
4	LIPJAN	55,044	338.41	17	10.86	16.26
5	OBILIQ	22,815	104.84	62	4.50	5.04
6	PODUJEVË	70,975	632.59	20	14.00	30.40
7	GRAÇANICË	18,486	122.42	77	3.65	5.88
	GJITHSEJ	506,814	2,081	270	100	100



⁷ <https://ask.rks-gov.net/> Vlerësimi i popullsisë 2024

LEVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN QENDËR

Të dhënat paraqesin një pasqyrë të detajuar të popullsisë së vlerësuar në komunat e rajonit Qendër më 31 dhjetor 2023, si dhe lëvizjet ndërkombëtare dhe kombëtare të popullsisë për vitin 2024 në nivel të këtyre komunave. Të gjitha komunat e paraqitura japin një pasqyrim të ndryshimeve demografike të shkaktuara nga migrimi ndërkombëtar dhe kombëtar.

Migrimi ndërkombëtar përfshin imigrimin nga jashtë në Kosovë dhe emigrimin e qytetarëve jashtë vendit.

Gjatë vitit 2024 gjithsej janë regjistruar 3,039 imigrime dhe 8,995 emigrime ndërkombëtare, që rezultojnë në një bilanc negativ prej -5,956 banoreve.

Komunat që shënojnë bilancin më negativ të migrimit ndërkombëtar janë Podujeva -1,819 dhe Gllogoci -1,519, Graçanica është e vetmja komune me bilanc pozitiv në këtë rajon, me 56 banor.

Migrimi kombëtar reflekton lëvizjen e popullsisë brenda territorit të Kosovës.


Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 11,688 imigrime dhe 8,014 emigrime kombëtare, duke rezultuar në një bilanc pozitiv prej 3,674 banor. Komunat me bilancin pozitiv të migrimit kombëtar janë: Fushë Kosova me 3,796 banor, prishtina me 1,200 banor dhe Graçanica me 629 banor ndërsa komunat me bilanc më të lartë negativ të migrimit kombëtar janë: Podujeva me -1,122 banor dhe Gllogovci me -570 banor. Totali i bilancit të përgjithshëm që llogaritet kombinimin e migrimit ndërkombëtar dhe atij kombëtar për komunat e përfshira është -2,282 banor, që tregon se popullsia e përgjithshme e këtij rajoni ka pësuar ulje për shkak të migrimit.

Komunat me bilanc pozitiv të migrimit të përgjithshëm të migrimit janë: Fushë Kosova me 3,619 banor dhe Graçanica me 685 banor ndërsa komunat me humbjen më të madhe të popullsisë për shkak të migrimit të përgjithshëm janë: Podujeva -2,941 si dhe Gllogoci -2,089. Popullsia e përgjithshme, duke përfshirë lëvizjet e popullsisë për vitin 2024, arrin në 500,741 banor, që përfaqëson një ulje krahasuar me popullsinë e vlerësuar të vitit 2023.


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024

NR.	KOMUNAT	POPULLSIA E VLERËSUAR (31 DHJETOR 2023)	MIGRIMI NDERKOMBËTAR (2024)			MIGRIMI KOMBËTAR (2024)			BILANCI PËRGJITHSHËM I MIGRIMIT NË NIVEL TË KOMUNAVE 2024	GJITHSEJ POPULLSIA DHE MIGRIMI
			IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT NDERKOMB.	IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT KOMBËTAR		
1	PRISHTINË	226,068	1,567	2,815	(1,248)	4,369	3,169	1,200	(48)	226,020
2	GLLOGOVC	48,696	173	1,692	(1,519)	589	1,159	(570)	(2,089)	46,607
3	FUSHË KOSOVË	60,209	683	860	(177)	4,518	722	3,796	3,619	63,828
4	GRAÇANICË	17,870	114	58	56	694	65	629	685	18,555
5	LIPJAN	55,098	258	1,229	(971)	700	767	(67)	(1,038)	54,060
6	OBILIQ	22,974	46	324	(278)	183	375	(192)	(470)	22,504
7	PODUJEVË	72,108	198	2,017	(1,819)	635	1,757	(1,122)	(2,941)	69,167
GJITHSEJ		503,023	3,039	8,995	-5,956	11,688	8,014	3,674	-2,282	500,741


PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR (2024)




PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT KOMBËTAR (2024)



PARAQITJA GRAFIKE E BILANCIT TE MIGRIMIT NE RAJONIN QENDER



PARAQITJA GRAFIKE BILANCI I PËRGJITHSHËM I MIGRIMIT NË NIVEL TË KOMUNAVE 2024



NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN QENDËR

Rajoni Qendër sipas te dhënave te ASK-së ka te regjistruar 6,857 lindje dhe 2,659 vdekje, duke rezultuar me një shtim natyror prej 4,198 banor në vitin 2024. Komuna me shtimin më të lartë natyror është Prishtina me 2870 lindje, pastaj është Podujeva me 1,075 lindje, ndërsa komuna me numër më të ulët te lindjeve ne rajonin Qendër është Graçanica me 151 lindje ne vitin 2024.

Sa i përket numrit te vdekjeve dhe shtimit natyror te popullsisë për vitin 2024, komuna e Prishtinës ka numrin me te madhe, 1,152 vdekje dhe shtim natyror prej 1,718 banor pastaj komuna e Podujevës 448 vdekje dhe shtim natyror prej 627 banor ndërsa komuna e Graçanicës është me numrin me te vogël 114 vdekje dhe shtimit natyror 37 banor.


Këto tregues janë të rëndësishëm për analizimin e potencialit demografik, planifikimit lokal dhe identifikimit të tendencave të rritjes së popullsisë në Rajonin Qendër.

Tabela paraqet të dhënat mbi numrin e lindjeve, vdekjeve dhe shtimin natyror të popullsisë në Rajonin Qendër për vitin 2024, të ndara sipas komunave, dhe ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi dinamikën demografike rajonale, duke evidentuar nivelin e rritjes natyrore të popullsisë në secilën komunë te rajonit Qendër.

PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NATALITETIT, MORTALITETIT DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN QENDËR PËR VITIN 2024

NR.	KOMUNA	NUMRI I LINDJEVE 2024	NUMRI I VDEKJEVE 2024	SHTIMI NATYROR 2024
1	PRISHTINË	2870	1152	1718
2	GLLOGOC	782	268	514
3	FUSHË KOSOVË	804	238	566
4	GRAÇANICË	151	114	37
5	LIPJAN	793	283	510
6	OBILIQ	382	156	226
7	PODUJEVË	1075	448	627
	GJITHSEJ	6,857	2,659	4,198

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN QENDËR PËR VITIN 2024



STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN QENDËR

Struktura demografike e popullsisë për komunat e Rajonit Qendër, të ndarë sipas tre grupmoshave kryesore (0-14 vjeç, 15-64 vjeç, dhe 65+ vjeç) si dhe sipas gjinisë (femra dhe meshkuj), mundëson analizimin e profilit demografik, identifikimin e dallimeve strukturore ndërmjet komunave dhe vlerësimin e potencialit ekonomik, social dhe zhvillimor të rajonit.

Në Rajonin Qendër, popullsia totale arrin në 506,814 banor, prej të cilëve: 117,008 janë fëmijë dhe të rinj (0-14 vjeç), 339,634 janë në moshë pune (15-64 vjeç) dhe 50,172 janë mbi 65 vjeç. Struktura gjinore tregon një shpërndarje të balancuar: Femra: 253,161 dhe Meshkuj: 253,653.

Sa i përket analizës se të dhënave të komunave të këtij rajoni del se Prishtina ka numër më të madhë të popullsisë 227,466 banor. Struktura e moshës është dominuar nga grupmosha 15-64 vjeç me 153,436 banor, duke reflektuar një fuqi të madhe punëtore dhe një strukturë relativisht të re, ndërsa grupmoshat 0 - 14 vjeç me 50,164 banor dhe 65+ me 23,866 banor. Raporti gjinor është pothuajse i balancuar.

Gllgovci paraqet një strukturë të qëndrueshme demografike me 48,079 banor. Dominon grupmosha 15-64 në moshë pune me 31,710 banor. Fëmijët përbëjnë rreth një të katërtën e popullsisë, me 11,803 banor, ndërsa grupmosha 65+ është relativisht e ulët 4,566.

Fushë Kosova karakterizohet nga një popullsi e re, me 16,510 banor në grupmoshën 0-14 vjeç, me 42,524 banor grupmosha 15 - 64 vjeç dhe vetëm me 4,915 banor grupmosha 65+. Popullsia totale është 63,949, me raport gjinor të ekuilibruar.

Graçanica ka strukturën më të vogël të popullsisë me 18,486 banor, me përqindje më të ulët të popullsisë mbi 65 vjeç 2,356. Struktura gjinore është: 8,786 femra dhe 9,700 meshkuj.

Lipjani ka një profil të fortë demografik me 55,044 banor, nga të cilët 13,240 i përkasin grupmoshës 0-14 vjeç, 36,602 banor grupmosha 15 - 64 si dhe mbi 65 vjeç 5,202 banor. Struktura gjinore është: 27,141 femra dhe 27,903 meshkuj.


Obiliqi ka popullsi me 22,815 banor prej të cilëve 5,448 banor në grupmoshën 0-14, grupi i moshës së punës është 15,176 banor dhe përbën pjesën më të madhe të popullsisë, ndërsa grupmosha 65+ qëndron në nivele të ulëta me 2,191 banor.

Podujeva ka popullsi me 70,975 banor, duke u renditur pas Prishtinës nga të cilët 16,163 i përkasin grupmoshës 0-14 vjeç, 47,736 banor grupmosha 15 - 64 si dhe mbi 65 vjeç 7,076 banor. Struktura gjinore është: 35,155 femra dhe 35,820 meshkuj.


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË

NR.	KOMUNA	GRUPMOSHA - GJITHSEJ				GRUPMOSHA - FEMRA				GRUPMOSHA - MASHKUJ			
		0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ
1	PRISHTINË	50,164	153,436	23,866	227,466	23,936	78,286	12,660	114,882	26,228	75,150	11,206	112,584
2	GLLOGOVC	11,803	31,710	4,566	48,079	5,662	15,918	2,365	23,945	6,141	15,792	2,201	24,134
3	F. KOSOVË	16,510	42,524	4,915	63,949	7,831	21,659	2,612	32,102	8,679	20,865	2,303	31,847
4	GRAÇANICË	3,680	12,450	2356	18,486	1,786	5,779	1221	8,786	1,894	6,671	1135	9,700
5	LIPJAN	13,240	36,602	5,202	55,044	6,324	18,109	2,708	27,141	6,916	18,493	2,494	27,903
6	OBILIQ	5,448	15,176	2191	22,815	2,595	7,420	1135	11,150	2,853	7,756	1056	11,665
7	PODUJEVË	16,163	47,736	7,076	70,975	7,848	23,690	3,617	35,155	8,315	24,046	3,459	35,820
GJITHSEJ		117,008	339,634	50,172	506,814	55,982	170,861	26,318	253,161	61,026	168,773	23,854	253,653

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE PËR VITIN 2024



PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TË POPULLSISË SIPAS GJINISË PER VITIN 2024



NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT VERI



Rajoni Veri përbëhet nga komunat: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Ka popullsi prej 190,591 banor, 97,367 mashkuj dhe 93,224 femra dhe përbën 11.89% të tërë popullsisë së Republikës së Kosovës, me sipërfaqe prej 2,051.84 km² dhe 18.82% të totalit të sipërfaqes së Republikës së Kosovës. Rajoni Veri ka 336 vendbanime. Dendësia e popullsisë në Rajonin Veri është 93 banorë në 1 km².

Dendësinë më të madhe të popullsisë në Rajonin Veri e ka komuna e Mitrovicës së Veriut me 1,160 banor në 1km² ndërsa dendësinë me te vogël te popullsisë e ka Zubin Potoku me 10 banor ne 1km².



PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT VERI

NR	KOMUNAT	REGJISTRIMI I POPULLËSISË 2024	SIPERFAQJA km ²	VENDBANIMET	% E PJESËMARRJËS SË POPULLËSISË SË KOMUNAVE NË TOTALIN E POPULLËSISË SË RAJONIT	% E PJESËMARRJËS SË SIPERFAQËS SË KOMUNAVE NË TOTALIN E SIPERFAQËS SË RAJONIT
1	MITROVICË	64,742	329.35	46	33.97	16.05
2	SKENDERAJ	40,664	374.37	49	21.34	18.25
3	VUSHTRRI	61,528	344.85	67	32.28	16.81
4	MITROVICË E VER.	7,920	6.83	3	4.16	0.33
5	LEPOSAVIQ	9,485	539.05	75	4.98	26.27
6	ZUBIN POTOK	3,385	334.38	35	1.78	16.30
7	ZVEÇAN	2,867	123.01	61	1.50	6.00
GJITHSEJ		190,591	2,052	336	100	100



LËVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN VERI

Popullsia e vlerësuar për Rajonin Veri në vitin 2023 ishte 192,035 banorë. Gjatë vitit 2024, migrimi ka ndikuar dukshëm në strukturën demografike. Sipas të dhënave të paraqitura me poshtë numri i personave që kanë imigruar në Kosovë nga jashtë (imigrantë ndërkombëtarë) gjatë vitit 2024 është gjithsej 808 banor, ndërsa numri i personave që janë larguar nga Kosova për të jetuar jashtë vendit (emigrantë ndërkombëtarë) gjatë vitit 2024 është gjithsej 4,036 banor. Bilanci i migrimit ndërkombëtar është negativ -3,228 banor.

Sa i përket migrimit kombëtar numri i personave që kanë imigruar në rajonin veri nga rajonet tjera (imigrantë kombëtar) gjatë vitit 2024 është gjithsej 1,978 banor, ndërsa numri i personave që janë larguar nga rajoni veri (emigrantë kombëtar) gjatë vitit 2024 është gjithsej 3,379 banor. Bilanci i migrimit kombëtar është negativ -1,401 banor.

Te gjitha komunat e këtij rajoni janë me bilanc negativ, mirëpo komunat me humbjen më të madhe të popullsisë për shkak të migrimit është: Vushtrria -1,900 banor si dhe Skenderaj -1,539 banor .

Bilanci i përgjithshëm i migrimit në rajon është -4,629, duke treguar një ulje të popullsisë si rezultat i emigrimit të lartë. Pas migrimit të popullsisë rajoni Veri ka 187,406 banor.

Sipas këtyre të dhënave rajoni Veri po përballet me zbrazje të popullsisë, ku emigrimi ndërkombëtar është faktori kryesor. Tri komunat më të mëdha (Mitrovica, Skenderaj, Vushtrria) kontribuojnë mbi 90% të humbjes totale të popullsisë.


Migrimi kombëtar gjithashtu paraqitet negativ, çka tregon lëvizje të brendshme të popullsisë drejt rajoneve më të zhvilluara të vendit.

Komunat më të vogla (Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok) kanë lëvizje modeste, por gjithsesi me trend negativ.


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024

NR.	KOMUNAT	POPULLSIA E VLERËSUAR (31 DHJETOR 2023)	MIGRIMI NDERKOMBËTAR (2024)			MIGRIMI KOMBËTAR (2024)			BILANCI PËRGJITHSHËM I MIGRIMIT NË NIVEL TË KOMUNAVE 2024	GJITHSEJ POPULLSIA DHE MIGRIMI
			IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI MIGRIMIT NDERKOMBËTAR	IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI MIGRIMIT KOMBËTAR		
1	MITROVICË	64,937	287	1,193	(906)	671	844	(173)	(1,079)	63,858
2	SKENDERAJ	41,316	340	1,181	(841)	856	1,554	(698)	(1,539)	39,777
3	VUSHTRRI	62,046	167	1,599	(1,432)	423	891	(468)	(1,900)	60,146
4	MITROVICA E V.	7,951	8	33	(25)	13	39	(26)	(51)	7,900
5	LEPOSAVIQ	9,500	6	7	(1)	13	20	(7)	(8)	9,492
6	ZVEQAN	2,883	-	4	(4)	1	15	(14)	(18)	2,865
7	ZUBIN POTOK	3,402	-	19	(19)	1	16	(15)	(34)	3,368
GJITHSEJ		192,035	808	4,036	-3,228	1,978	3,379	-1,401	-4,629	187,406

PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR (2024)



PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT KOMBËTAR (2024)



NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN VERI

Tabela paraqet gjendjen demografike në komunitat e Rajonit Veri për vitin 2024, duke u fokusuar në tre tregues kryesorë: numrin e lindjeve, numrin e vdekjeve dhe shtimin natyror të popullsisë. Këta tregues janë të rëndësishëm për të vlerësuar dinamikën natyrore të popullsisë dhe për të identifikuar zonat me rritje apo zvogëlim demografik.

Rajoni Veri sipas të dhënave të ASK-së ka të regjistruar 2,533 lindje dhe 1,378 vdekje, duke rezultuar me një shtim natyror prej 1,155 banor në vitin 2024. Komuna me shtimin më të lartë natyror është Vushtrria me 513 banor, pastaj është Mitrovica me 344 banor, ndërsa komuna me shtim natyror negativ në rajonin Veri janë: Leposaviqi me -13 banor dhe Zveçani me -6 banor.

Të dhënat sipas Komunave: Mitrovicë (Lindje: 800, Vdekje: 456, Shtimi natyror: 344), Skenderaj (Lindje: 595, Vdekje: 316, Shtimi natyror: 279), Vushtrri (Lindje: 917, Vdekje: 404, Shtimi natyror: 513), Mitrovicë e Veriut (Lindje: 103, Vdekje: 78, Shtimi natyror: 25), Leposaviq (Lindje: 37, Vdekje: 50, Shtimi natyror: -13), Zveçan (Lindje: 36, Vdekje: 42, Shtimi natyror: -6), Zubin Potok (Lindje: 45, Vdekje: 32, Shtimi natyror: 13).


Këto të dhëna tregojnë se rajoni, në tërësi, ka një shtim natyror pozitiv. Pra tri komunat me shtim natyror më të lartë janë Vushtrria, Mitrovica dhe Skenderaj. Komunat Leposaviq dhe Zveçan shënojnë rënie natyrore, e cila mund lidhet me moshën mesatare më të lartë ose emigrimin e të rinjve.

Rajoni në tërësi shfaq potencial demografik pozitiv, por me dallime të qarta midis komunave.

PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN VERI PËR VITIN 2024

NR.	KOMUNA	NUMRI I LINDJEVE 2024	NUMRI I VDEKJEVE 2024	SHTIMI NATYROR 2024
1	MITROVICË	800	456	344
2	SKENDERAJ	595	316	279
3	VUSHTRRI	917	404	513
4	MITROVICË E VERIUT	103	78	25
5	LEPOSAVIQ	37	50	-13
6	ZVEÇAN	36	42	-6
7	ZUBIN POTOK	45	32	13
GJITHSEJ		2,533	1,378	1,155

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN VERI PËR VITIN 2024



STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN VERI

Tabela paraqet shpërndarjen e popullsisë së rajonit Veri sipas tre grupmoshave kryesore: 0–14 vjeç, 15–64 vjeç, dhe 65+, të ndara gjithashtu sipas gjinisë femra dhe meshkuj dhe sipas komunave përkatëse: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Popullsia totale e rajonit arrin në 190,591 banor. Shpërndarja sipas moshës është: 0–14 vjeç: 40,460 banor, 15–64 vjeç: 126,459 banor, 65+ vjeç: 23,672 banor.

Komuna me popullsinë më të madhe është Mitrovica me 64,742 banor, 14,571 te grupmoshës 0-14 vjeç, 42,784 te grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 7,387 te grupmoshës mbi 65 vjeç. Pastaj Vushtrria me 61,528 banor, 13,937 te grupmoshës 0-14 vjeç, 41,079 te grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 6,512 te grupmoshës mbi 65 vjeç. Skenderaj me 40,664 banor, 8,993 te grupmoshës 0-14 vjeç, 27,200 te grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 4,471 te grupmoshës mbi 65 vjeç. Ndërsa komunat tjera kanë popullsi me te vogël: Leposaviqi me 9,485 banor, prej te cilëve me 1,050 banor te grupmoshës 0-14 vjeç, 6,214 banor te grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 2,221 banor te grupmoshës mbi 65 vjeç.

Zubin Potoku me 3,385 banor, 445 banor te grupmoshës 0-14 vjeç, 2,205 te grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 735 te grupmoshës mbi 65 vjeç. Komuna me e vogël ne kete rajon është Zveçani me 2,867 banor, 377 te grupmoshës 0-14 vjeç, 1,859 te grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 631 te grupmoshës mbi 65 vjeç.

Sa i përket gjinisë, numri total i femrave në rajonin veri është 93,224. Struktura e grupmoshave te gjinisë femërore ne këtë rajon është: 0–14 vjeç: 19,308 femra, 15–64 vjeç: 61,833 femra, 65+ vjeç: 12,083 femra.

Ndërsa numri total i meshkujve arrin në 97,367 banor. Shpërndarja sipas moshës: 0–14 vjeç: 21,152 mashkuj, 15–64 vjeç: 64,626 mashkuj, 65+ vjeç: 11,589 meshkuj.


Grupmosha dominuese në rajon është ajo 15–64 vjeç, që përfaqëson shumicën e popullsisë si te femrat ashtu edhe te meshkujt. Vushtrria, Mitrovica dhe Skenderaj janë komunat më të mëdha, me strukturë më të re të popullsisë.

Raporti gjinor është i balancuar, me një epërsi të lehtë të meshkujve (97,367) ndaj femrave (93,224).


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË

GRUPMOSHA - GJITHSEJ						GRUPMOSHA - FEMRA				GRUPMOSHA - MASHKUJ			
NR.	KOMUNA	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ
1	MITROVICË	14,571	42,784	7,387	64,742	7,017	21,164	3,920	32,101	7,554	21,620	3,467	32,641
2	SKENDERAJ	8,993	27,200	4,471	40,664	4,329	13,347	2,307	19,983	4,664	13,853	2,164	20,681
3	VUSHTRRI	13,937	41,079	6,512	61,528	6,570	20,070	3,272	29,912	7,367	21,009	3,240	31,616
4	MITROVICA E V.	1,087	5,118	1,715	7,920	520	2,452	846	3,818	567	2,666	869	4,102
5	LEPOSAVIQ	1,050	6,214	2,221	9,485	479	2,894	1,076	4,449	571	3,320	1,145	5,036
6	ZVEQAN	377	1,859	631	2,867	180	866	305	1,351	197	993	326	1,516
7	ZUBIN POTOK	445	2,205	735	3,385	213	1,040	357	1,610	232	1,165	378	1,775
GJITHSEJ		40,460	126,459	23,672	190,591	19,308	61,833	12,083	93,224	21,152	64,626	11,589	97,367

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE POPULLSISE SË RAJONIT VERI SIPAS GRUPMOSHAVE PER VITIN 2024



PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE POPULLSISE SË RAJONIT VERI SIPAS GJINISË PER VITIN 2024





NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT PERËNDIM

Rajoni Perëndim përbëhet nga 4 komuna: Pejë, Deçan, Istog dhe Klinë. Rajoni Perëndim ka popullsi 174,031 banor, 86,499 femra dhe 87,532 meshkuj dhe përbën 10.86% të popullsisë së Republikës së Kosovës, me sipërfaqe prej 1,659.98 km² dhe 15.22% të totalit të sipërfaqes së Republikës së Kosovës. Rajoni Perëndim përfshin 220 vendbanime. Dendësia e popullsisë në Rajonin Zhvillimor të Pejës është 105 banorë në 1 km². Dendësinë më të madhe të popullsisë në këtë rajon e ka komuna e Pejës me 137 banorë në 1km².



PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT PERËNDIM

NR	KOMUNAT	REGJISTRIMI I POPULLSISË 2024	SIPERFAQJA km ²	VENDBANIMET	% E PJESËMARRJËS SË POPULLSISË SË KOMUNAVE NË TOTALIN E POPULLSISË SË RAJONIT	% E PJESËMARRJËS SË SIPERFAQËS SË KOMUNAVE NË TOTALIN E SIPERFAQËS SË RAJONIT
1	PEJË	82,745	602.63	79	47.55	36.30
2	DEÇAN	27,775	293.97	37	15.96	17.71
3	ISTOG	33,008	454.36	50	18.97	27.37
4	KLINË	30,503	309.02	54	17.53	18.62
GJITHSEJ		174,031	1,659.98	220	100	100



LËVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN PERËNDIM

Tabela paraqet të dhënat demografike për komunat e rajonit Perëndim, popullsinë e vlerësuar në fund të vitit 2023 me të dhënat e migrimit ndërkombëtar dhe kombëtar për vitin 2024. Ajo ofron një pasqyrë të qartë mbi lëvizjet e popullsisë dhe ndikimin e tyre në numrin përfundimtar të popullsisë për secilën komunë të këtij rajoni. Popullsia e përgjithshme e komunave të përfshira është 174,031 banor, e shpërndarë si vijon: Pejë 82,745 banor, Istog 33,008 banor, Deçan 27,775 banor dhe Klina 30,503 banor.

Migrimi ndërkombëtar përbëhet nga: Totali i imigrimit ndërkombëtar: 778 banor, totali i emigrimit ndërkombëtar: 4,507 banor.

Bilanci i migrimit ndërkombëtar sipas komunave të këtij rajoni është: Peja -1,429, Istogu -706, Deçani -454 dhe Klina -1,140, ndërsa bilanci i migrimit ndërkombëtar në total i këtij rajoni është: -3,729 që tregon se rajoni ka humbje të konsiderueshme të popullsisë drejt shteteve të tjera, pra në secilën komunë numri i largimeve jashtë vendit tejkalon ndjeshëm hyrjet.

Migrimi kombëtar përfshin lëvizjet brenda territorit të Kosovës: Imigrimi kombëtar: 1,453, Emigrimi kombëtar: 2,047, Bilanci kombëtar: -594.

Edhe brenda vendit, komunat regjistrojnë një bilanc negativ (Peja -168, Istogu -164, Deçani -96 dhe Klina: -166), që tregon se më shumë banor lëvizin drejt rajoneve të tjera se sa kthehen në rajonin Perëndim.

Bilanci i përgjithshëm i migrimit është shuma e bilancit ndërkombëtar dhe kombëtar.

Bilanci i përgjithshëm i migrimit në nivel të komunave të rajonit perëndim është: Peja -1,597, Istogu -870, Deçani -550 dhe Klina -1,306, ndërsa bilanci total i migrimit kombëtar të këtij rajoni është: -4,323 që tregon humbje të dukshme të popullsisë gjatë vitit 2024.


Si rezultat i migrimit, popullsia për vitin 2024 bie në 170,479 banor, pra ka një rënie prej 4,323 banoreve krahasuar me fundin e vitit 2023.

Të gjitha komunat regjistrojnë bilance të theksuara negative migrimi, me emigrim të lartë ndërkombëtar dhe kombëtar. Peja dhe Klina janë komunat më të prekura nga emigrimi jashtë vendit.


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024

NR.	KOMUNAT	POPULLSIA E VLERËSUAR (31 DHJETOR 2023)	MIGRIMI NDERKOMBËTAR (2024)			MIGRIMI KOMBËTAR (2024)			BILANCI I PËRGJITHSHËM I MIGRIMIT NË NIVEL TË KOMUNAVE 2024	GJITHSEJ POPULLSIA DHE MIGRIMI
			IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT NDERKOMBËTAR	IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT KOMBËTAR		
1	PEJË	82,971	417	1,846	(1,429)	602	770	(168)	(1,597)	81,374
2	ISTOG	33,212	147	853	(706)	227	391	(164)	(870)	32,342
3	DEÇAN	27,883	131	585	(454)	148	244	(96)	(550)	27,333
4	KLINË	30,736	83	1,223	(1,140)	476	642	(166)	(1,306)	29,430
GJITHSEJ		174,802	778	4,507	-3,729	1,453	2,047	-594	-4,323	170,479

PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR (2024)



PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT KOMBËTAR (2024)



NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN PERËNDIM


Në vitin 2024, në komnat Pejë, Istog, Deçan dhe Klinë janë regjistruar gjithsej 2,100 lindje dhe 1,275 vdekje, duke rezultuar me një shtim natyror pozitiv prej 825 banor.

Komuna e Pejës kryeson si për nga numri i lindjeve (963), për nga numri i vdekjeve (587), ashtu edhe për nga shtimi natyror (376), duke reflektuar peshën e saj demografike në rajon. Pastaj vijojne komnat tjera të këtij rajoni: Klina është me: 443 lindje, 212 vdekje dhe me shtim natyror prej 231, pastaj Istogu me: 383 lindje, 261 vdekje dhe me shtim natyror prej 122 dhe Deçani me: 311 lindje, 215 vdekje dhe me shtim natyror prej 96.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një rritje natyrore pozitive të popullsisë në të gjitha komnat e përfshira, me dallime të moderuara ndërmjet tyre, që lidhen kryesisht me madhësinë dhe strukturën demografike të secilës komunë.

PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E NUMRIT TE LINDJEVE, VDEKJEVE DHE SHTIMI NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN PERENDIM PËR VITIN 2024

NR.	KOMUNA	NUMRI I LINDJEVE 2024	NUMRI I VDEKJEVE 2024	SHTIMI NATYROR 2024
1	PEJË	963	587	376
2	ISTOG	383	261	122
3	DEÇAN	311	215	96
4	KLINË	443	212	231
GJITHSEJ		2,100	1,275	825



STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË NË RAJONIN PERENDIM

Të dhënat paraqesin strukturën e popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë për komunat Pejë, Istog, Deçan dhe Klinë.

Në nivel rajonal, popullsia totale arrin në **174,031** banorë, prej të cilëve: 35,820 janë fëmijë dhe të rinj (0-14 vjeç), 115,874 janë në moshë pune (15-64 vjeç) dhe 22,337 janë mbi 65 vjeç. Struktura gjinore është: Femra: 87,532 dhe Meshkuj: 86,499.

Sa i përket analizës se të dhënat e komunave të Rajonit Perëndim del se Peja ka numër më të madhe të popullsinë me 82,745 banor. Struktura e moshës është: me 16,765 banor grupmosha 0-14 vjeç, me 55,122 banor grupmosha 15-64 vjeç duke reflektuar një fuqi të madhe punëtore dhe një strukturë relativisht të re, ndërsa grupmosha 65+ me 10,858 banor. Raporti gjinor është pothuajse i balancuar. Komunat e tjera Istogu, Klina dhe Deçani kanë popullsi dukshëm më të vogël, por ruajnë një strukturë të ngjashme moshore, me dominim të grupmoshës 15-64 vjeç. Istogu ka 33,008 banor , 6,623 të grupmoshës 0-14 vjeç, 22,228 të grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 4,157 të grupmoshës mbi 65 vjeç. Deçani me 27,775 banor , 5,637 të grupmoshës 0-14 vjeç, 18,448 të grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 3,690 të grupmoshës mbi 65 vjeç, ndërsa komuna më e vogla në këtë rajon është Klina me gjithsej 30,503 banor prej të cilëve 6,795 të grupmoshës 0-14 vjeç, 20,076 të grupmoshës 15-64 vjeç si dhe 3,632 të grupmoshës mbi 65 vjeç.


Grupmosha dominuese në rajon është ajo 15-64 vjeç, që përfaqëson shumicën e popullsisë si të femrat ashtu edhe të meshkujt.

Në tërësi, tabela tregon një strukturë demografike relativisht të qëndrueshme, me ekuilibër gjinor dhe potencial të konsiderueshëm socio-ekonomik nga popullsia aktive.


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E STRUKTURËS SË POPULLSISË SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË

		GRUPMOSHA - GJITHSEJ				GRUPMOSHA - FEMRA				GRUPMOSHA - MASHKUJ			
NR.	KOMUNA	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ	0 - 14	15-64	65+	GJITHSEJ
1	PEJË	16,765	55,122	10,858	82,745	8025	27855	5780	41,660	8740	27267	5078	41,085
2	ISTOG	6,623	22,228	4,157	33,008	3262	11077	2172	16,511	3361	11151	1985	16,497
3	DEÇAN	5,637	18,448	3,690	27,775	2,726	9,146	2,015	13,887	2,911	9,302	1,675	13,888
4	KLINË	6,795	20,076	3,632	30,503	3,279	10,305	1,890	15,474	3,516	9,771	1,742	15,029
GJITHSEJ		35,820	115,874	22,337	174,031	17,292	58,383	11,857	87,532	18,528	57,491	10,480	86,499

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE POPULLSISE SË RAJONIT PERENDIM
SIPAS GRUPOSHAVE PËR VITIN 2024



PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE POPULLSISE SË RAJONIT PERENDIM
SIPAS GJINISË PËR VITIN 2024



NUMRI I POPULLSISË, DENDËSIA, VENDBANIMEVE DHE SIPËRFAQJA E RAJONIT JUG


Rajoni Jug përbëhet nga 4 komuna: Prizren, Dragash, Mamushë dhe Suharekë. Ky rajon ka popullsi 227,498 banorë, 113,735 femra dhe 113,763 mashkuj dhe përbën 14.20% të popullsisë së Republikës së Kosovës, me sipërfaqe prej 1,432.69 km² dhe 13.14% të totalit të sipërfaqës së Republikës së Kosovës. Rajoni Jug përfshin 154 vendbanime. Dendësia e popullsisë në Rajonin Jug është 159 banorë në 1km². Dendësinë më të madhe të popullsisë në këtë rajon e ka komuna e Mamushës me 513 banor në 1km².




PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E POPULLSISË DHE SIPERFAQËS SË RAJONIT JUG

NR	KOMUNAT	REGJISTRIMI I POPULLËSISË 2024	SIPERFAQJA km ²	VENDBANIMET	% E POPULLËSISË SË KOMUNAVE NË TOTALIN E POPULLËSISË SË RAJONIT	% E SIPERFAQËS SË KOMUNAVE NË TOTALIN E SIPERFAQËS SË RAJONIT
1	PRIZREN	147,246	626.86	76	64.72	43.75
2	DRAGASH	28,896	433.85	36	12.70	30.28
3	SUHAREKË	45,749	361.04	1	20.11	25.20
4	MAMUSHË	5,607	10.94	41	2.46	0.76
GJITHSEJ		227,498	1,432.69	154	100	100

% E POPULLËSISË SË KOMUNAVE NË TOTALIN E POPULLËSISË SË RAJONIT



% E SIPERFAQËS SË KOMUNAVE NË TOTALIN E SIPERFAQËS SË RAJONIT



LEVIZJET E POPULLSISË NË RAJONIN JUG

Ne këtë analizë përfshihet vlerësimi i popullsisë së rajonit Jug në vitin 2023 dhe lëvizjet e popullsisë për vitin 2024, konkretisht për komunat: Prizren, Dragash, Mamushë dhe Suharekë.

Sipas të dhënave të paraqitura me poshtë numri i personave që kanë ardhur në Rajonin Jug nga jashtë (imigrant ndërkombëtar) gjatë vitit 2024 është gjithsej 1,653 persona, ndërsa numri i personave që janë larguar nga Kosova për të jetuar jashtë vendit (emigrant ndërkombëtar) gjatë vitit 2024 është gjithsej 5,555 persona. Bilanci i migrimit ndërkombëtar është negativ -3,902 banor.

Sa i përket migrimit kombëtar numri i personave që kanë imigruar në Rajonin Jug nga rajonet tjera (imigrant kombëtar) gjatë vitit 2024 është gjithsej 1,276 persona, ndërsa numri i personave që janë larguar nga Rajoni Jug (emigrant kombëtar) gjatë vitit 2024 është gjithsej 1,663 banor. Bilanci i migrimit kombëtar është negativ -387 banor.

Bilanci i përgjithshëm i migrimit është shuma e bilancit ndërkombëtar dhe kombëtar.


Bilanci i përgjithshëm në nivel komunave të Rajonit Jug është: Prizreni me -2,264 banor, Suhareka me -1,571 banor, Dragashi me -441 banor dhe Mamusha me -13 banor. Ndërsa bilanci i përgjithshëm i migrimit të këtij rajoni është: -4,289 banor, që tregon humbje të dukshme të popullsisë gjatë vitit 2024. Si rezultat i migrimit, popullsia për vitin 2024 ka rënie krahasuar me fundin e vitit 2023 duke treguar një ulje të popullsisë si rezultat i emigrimit të lartë. Pas migrimit numri i popullsisë në rajonin Jug është 223,671 banor.

Emigrimi është dukshëm më i lartë se imigrimi, çka ka ndikuar në rënie të numrit të përgjithshëm të popullsisë;


PARAQITJA TABELARE DHE GRAFIKE E MIGRIMIT NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR TË POPULLSISË 2024

NR.	KOMUNAT	POPULLSIA E VLERËSUAR (31 DHJETOR 2023)	MIGRIMI NDËRKOMBËTAR (2024)			MIGRIMI KOMBËTAR (2024)			BILANCI I PËRGJITHSHËM I MIGRIMIT NË NIVEL TË KOMUNAVE 2024	GJITHSEJ POPULLSIA DHE MIGRIMI
			IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR	IMIGRIMI	EMIGRIMI	BILANCI I MIGRIMIT KOMBËTAR		
1	PRIZREN	147,288	1,347	3,568	(2,221)	918	961	(43)	(2,264)	145,024
2	DRAGASH	29,043	102	404	(302)	130	269	(139)	(441)	28,602
3	MAMUSHË	5,596	6	19	(13)	1	1	-	(13)	5,583
4	SUHAREKË	46,033	198	1,564	(1,366)	227	432	(205)	(1,571)	44,462
	GJITHSEJ	227,960	1,653	5,555	-3,902	1,276	1,663	-387	-4,289	223,671

PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT NDËRKOMBËTAR (2024)



PARAQITJA GRAFIKE E MIGRIMIT KOMBËTAR (2024)



NATALITETI, MORTALITETI DHE SHTIMIN NATYROR I POPULLSISË NE RAJONIN JUG


Tabela paraqet të dhënat për lindjet, vdekjet dhe shtimin natyror të popullsisë në Rajonin Jug për vitin 2024. Në total, janë regjistruar 2,707 lindje dhe 1,477 vdekje, duke rezultuar me një shtim natyror pozitiv prej 1,230 banorësh.

Komuna e Prizrenit ka peshën kryesore në rajon, me numrin më të lartë të lindjeve (1,858), 944 vdekje dhe një shtim natyror prej 914, që përbën pjesën më të madhe të rritjes natyrore. Suhareka me 545 lindje, 317 vdekje dhe shtim natyror 228 banor, Dragashi me 228 lindje, 193 vdekje dhe shtim natyror prej 35 banor. Mamushë, ndonëse me numra absolutë më të vegjël, shënon një shtim natyror relativisht të favorshëm me 53 banor, 76 lindje dhe 23 vdekje.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se Rajoni Jug ka një trend pozitiv demografik në vitin 2024, por me dallime të theksuara ndërmjet komunave.

